

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kreu i Policisë tregon masat për nisjen e vitit të ri shkollor: Kamera inteligjente dhe kontrolle për drogën e sigurinë ushqimore
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/kreu-i-policise-tregon-masat-per-nisjen-e-vitit-te-ri-shkollor-ore-ndergjegjesuese-per-rreziket-do-te-bejme-kontrolle-te-vazhdueshme/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 09:07:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 09:04:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1d016303176e8ced99a359e95f68193f003bc883f189f40960680c3e7464a485
TEKSTI	31acae8e0b108187ce327161acf3913ef1ef3a7f8dbcc8c4184b8dcfb24af979
PAMJA	9bf80ac2409c333ed92e12bcb707ee67a086ea6c1af9dfde89cdcf623ef91efe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d27603f5b5c38a92083f4d51143d87065f415c0df0641265086443dab736abed
E MËPARSHMJA	1f5976df47163b3c06c8bb184e7a705e7c77a8a384631718f2d218c600905846
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d27603f5b5c38a92083f4d51143d87065f415c0df0641265086443dab736abed>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [Facebook Icon KOHA JONË NË FACEBOOK](#)

 [Facebook Icon KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [YouTube Icon KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

Kreu i Policisë tregon masat për nisjen e vitit të ri shkollor: Kamera inteligjente dhe kontrolle për drogën e sigurinë ushqimore

[Aktualitet Kryesore](#) E Shtunë, 12 Shtator 2026 11:04



Kryepolici Skënder Hita ka dalë ka folur lidhur me masat e marra nga Policia e Shtetit në kuadër të nisjes së vitit të ri shkollor, të hënën më 14 shtator.

Në një konferencë për mediat, Hita garantoi forcimin e masave dhe praninë e policisë në shkolla, duke shtuar se këtë vit shkollor do të shtohet dhe projekti Smart City, duke rritur edhe më shumë sipas tij sigurinë në shkolla.

 [Koha YouTube Channel](#)

Në vijim deklarata e plotë e Hitës:



Ju falënderoj që jeni këtu në këtë ditë pushimi, por tematika për të cilën dua të informoj qytetarët ka të bëjë me qasjen e re dhe masat e marra nga Policia e Shtetit me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, proces shumë i rëndësishëm për të gjithë shoqërinë, por njëkohësisht edhe një përgjegjësi e shtuar për Policinë e Shtetit. Mbrojtja e jetës, shëndetit dhe krijimi i një ambienti sa më të sigurt për zhvillimin e procesit mësimor të qetë në çdo cep të Shqipërisë është detyrë parësore e Policisë së Shtetit.



Pas analizës së problematikave të hasura gjatë viteve të kaluara, konsultimit dhe koordinimit me Ministrinë e Arsimit, Policia e Shtetit ka hartuar një plan të detajuar masash, me detyra konkrete për të gjitha strukturat që do të angazhohen për garantimin e sigurisë së nxënësve. Ky plan nuk lidhet vetëm me garantimin e sigurisë fizike të nxënësve, por masat tona përfshijnë edhe sigurinë ushqimore, sigurinë kibernetike dhe sigurinë rrugore.

Gjatë takimeve që kam zhvilluar së fundmi me strukturat vendore të Policisë së Shtetit, u kam lënë detyra të drejtpërdrejta dhe të qarta të gjithëve, për të marrë masa konkrete për garantimin e perimetrit të sigurisë dhe përtej perimetrit të sigurisë, me qëllim mbarrëvajtjen e procesit mësimor. Në krye të të gjitha shërbimeve të angazhuara për sigurinë në shkolla do të jenë shefat e komisariateve, të cilët do të kenë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për organizimin, koordinimin dhe kontrollin e shërbimeve në territor. Kam kërkuar që këto masa të mos mbeten vetëm në planifikim, por të kontrollohen dhe të zbatohen në terren. Përgjegjësia është konkrete dhe do të jetë e qartë për çdo drejtues vendor të Policisë.

Në këtë kuadër, kam udhëzuar specialistët e sektorëve kundër Narkotikëve dhe atyre Operacionalë në të 12 drejtoritë vendore të Policisë, që të organizojnë kontrolle me intensitet të lartë, si brenda, ashtu edhe jashtë perimetrit të sigurisë, me fokus identifikimin dhe ndalimin, me forcën e ligjit, të çdo elementi kriminal që tenton t'u afrohet institucioneve arsimore, të bëjë nxënësit pjesë të veprimtarive kriminale, veçanërisht në fushën e narkotikëve, apo t'u shesë atyre sende të tjera të kundërligjshme dhe me pasoja për jetën dhe shëndetin. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar edhe sigurisë rrugore pranë shkollave, për mbrojtjen e fëmijëve gjatë lëvizjes së tyre në fillim dhe në mbarim të orarit mësimor, si dhe gjatë pushimit të gjatë.

Rol të rëndësishëm në masat e ndërmarra nga Policia e Shtetit për garantimin e sigurisë dhe mbarrëvajtjen e vitit të ri shkollor ka edhe ndërgjegjësimi. Në këtë drejtim, strukturat e Policimit në Komunitet, të Dhunës në Familje, të Krimeve Kibernetike dhe të Policisë Rrugore do të jenë të pranishme në shkolla, me orë ndërgjegjësuese për rrezqet e bullizmit, dhunës psikologjike në shkolla dhe në hapësirën digjitale, për sigurinë rrugore, si dhe për reduktimin e përdorimit të drogës, duhanit dhe alkoolit. Gjithashtu, në kuadër të paketës së sigurisë në shkolla, po bashkëpunohet intensivisht me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për të garantuar sigurinë e produkteve ushqimore në të gjitha bizneset që operojnë pranë shkollave.

Do zhvillojmë kontrolle periodike në këto subjekte, për të verifikuar jo vetëm formalitetin e ushtrimit të aktivitetit të tyre ekonomik, por edhe përbërjen dhe skadencën e produkteve që konsumojnë nxënësit, si dhe kushtet higjieno-sanitare ku mbahen dhe tregtohen këto produkte. Në këtë sipërmarrje, rol të rëndësishëm luajnë edhe oficerët e sigurisë në shkolla, mësuesit dhe psikologët. Ata janë ura jonë e drejtpërdrejtë e lidhjes me përditshmërinë në shkollë dhe një pikë e rëndësishme kontakti për evidentimin në kohë të problematikave.

Për këtë arsye, ne po forcojmë bashkëpunimin me oficerët e sigurisë për të koordinuar veprimet për çdo rast dhe me drejtuesit e shkollave për të identifikuar dhe trajtuar çdo shqetësim apo problematikë që në hapat e saj të parë. Gjithashtu, partnerë të rëndësishëm të Policisë së Shtetit janë Bordet e Prindërve dhe Qeveritë e Nxënësve. Zëri i fëmijëve dhe shqetësimet e prindërve do të dëgjojnë me respekt dhe përgjegjshmëri dhe do të marrin përgjigje në kohë. Parandalimi është gjithmonë më i mirë se reagimi pas një ngjarjeje. Edhe në këtë drejtim, Shefat e Komisariateve do të jenë në krye të shërbimeve dhe përgjegjës në territorin që ata mbulojnë.

Të nderuar qytetarë!

Këtë vit, sigurisë në shkolla i shtohet edhe një tjetër dimension i rëndësishëm: teknologjia. Në kuadër të projektit Smart City, në 20 shkolla janë vendosur kamera inteligjente, të cilat trisin kapacitetet tona për monitorimin dhe parandalimin e situatave që mund të cenojnë sigurinë. Teknologjia na mundëson të jemi më të shpejtë në evidentimin e problematikave, më efikasë në reagim dhe më pranë qytetarëve, aty ku prania dhe ndërhyrja jonë kërkohet. Ky është një hap i rëndësishëm drejt një modeli modern të sigurisë publike, ku puna e punonjësit të Policisë në terren mbështetet gjithnjë e më shumë nga teknologjia dhe sistemet inteligjente.

Dhe dua ta them qartë: teknologjia nuk zëvendëson punonjësin e Policisë. Ajo e bën më të shpejtë, më efikas dhe më të saktë punën e tij në terren.

Të dashur nxënës,

Mos heshtni përballë një rreziku. Nëse shihni apo përballeni me një rast dhune, shpërndarjeje të narkotikëve, kërcënimesh, bullizmi, përfshirjes së bashkëmoshatarëve në veprimtari kriminale apo çdo situatë tjetër që ju shqetëson, njoftoni mësuesin, prindin, oficerin e sigurisë dhe Policinë e Shtetit.

Mos nguroni të flisni me prindërit, me psikologët, punonjësit socialë, mësuesit dhe me punonjësit e Policisë. Ndërhyrja në kohë për të trajtuar çdo problematikë apo shqetësim mund të parandalojë një ngjarje më të rëndë.

Policia e Shtetit dhe gjithë hallkat e zinxhirit të sigurisë do të jenë pranë jush dhe do të reagojnë me vendosmëri dhe profesionalizëm, që ju të ndiheni të qetë e të sigurt në rrugën e dijës. Ky është angazhimi ynë, shkolla të sigurt, për të ardhmen e vendit tonë! Faleminderit dhe jam i hapur për pyetje.

SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)



A duhet liru Erion Veliaj të drejtojë bashkinë nga zyra?

☐ Po

☐ Jo

Më shumë nga Aktualiteti



[Ra në kontakt me energjinë gjatë riparimit të linjës elektrike, humb ...](#)



[Arrestohet në Athinë i shumëkërkuari shqiptar, Hita jep detajet](#)



[Aksident në Tiranë, autobusi i linjës së Linzës përplasët me një makinë](#)



[ISHP: Check-up falas për të gjithë mbi 35 vjeç, zbulimi i hershëm shp...](#)



[Bashkia e Tiranës shpërndan mjete shkollore për fëmijët e familjeve n...](#)



[Reshjet e shiut fikin zjarret. Ministria e Mbrojtjes: Vetëm një vatër...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)



[SHBA zyrtarizon huanë 302 milionë dollarë për Shqipërinë, ministri Nufi: Partneritet strategjik](#)

2 minuta më parë



[Ra në kontakt me energjinë gjatë riparimit të linjës elektrike, humb jetën 32-vjeçari në Belsh](#)

7 minuta më parë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.